

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 15, neni 20 paragrafi 1 alinja 12, neni 87 dhe neni 88 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), në lidhje me nenin 15 paragrafi 1 alineja 14 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 12 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga 29.08.2014 e në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-1783/3 nga data 12.03.2015, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 10-të të mbajtur më 12.03.2015, miratoi

## **VENDIM**

### **PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË NGJARJEVE ME RËNDËSI TË MADHE PËR PUBLIKUN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

1. Me këtë Vendim përcaktohet lista e ngjarjeve (nacionale ose ndërkombëtare) emetimi televiziv i të cilave konsiderohet me rëndësi të madhe për popullsinë në Republikën e Maqedonisë dhe që përmbushin së paku 2 (dy), nga këto kritere:

- Ngjarja dhe përfundimi të kenë jehonë të madhe te popullsia e Republikës së Maqedonisë, e jo vetëm në atë pjesë e cila e përcjell rregullisht ngjarjen ose aktivitetet në fjalë;
- Ngjarja të ketë një vlerë të pranueshme distiktive dhe kulturore me rëndësi në përgjithësi te popullsia e Republikës së Maqedonisë dhe të përmbajë elemente për identitetin e tij kulturor;
- Të përfshijë reprezentacion nacional ose përfaqësues nacional në një sport të caktuar në ndonjë garë të madhe ndërkombëtare;
- Ngjarja të jetë emetuar tradicionalisht nga shërbimet programore televizive me qasje të lirë (televizioni falas), respektivisht të emetohet përmes kapacitetit emetues të multipleksit digjital terestrial dhe për të mos të paguhet kompensim shtesë, dhe të ketë tërhequr një publik të gjerë në Republikën e Maqedonisë. Taksa e radiodifuzionit nuk konsiderohet si kompensim shtesë.

2. Si ngjarje me rëndësi të madhe për Republikën e Maqedonisë përcaktohen:

- Lojërat olimpike dimërore;
- Lojërat olimpike verore;
- Garat kualifikuese që reprezentacioni maqedonas i futbollit në konkurrencë të burrave - senior, brenda ose jashtë vendit për plasim në Ligën evropiane në futboll;
- Gara me të cilën Liga Evropiane e futbollit shpallet e hapur, garat e gjysëmfinale, gara finale, dhe garat ku merr pjesë reprezentacioni i Maqedonisë në futboll në konkurrencë të meshkujve - seniorët;
- Garat kualifikuese që reprezentacioni maqedonas i futbollit në konkurrencë të meshkujve - senior, brenda ose jashtë vendit për plasim në Ligën botërore në futboll;
- Gara me të cilën Liga botërore e futbollit shpallet e hapur, garat e gjysëmfinale, gara finale, dhe garat ku merr pjesë reprezentacioni i Maqedonisë në futboll në konkurrencë të meshkujve - seniorët;
- Liga e UEFA-s për kampion në konkurrencë të meshkujve – seniorë; Garat gjysëmfinale, gara finale dhe garat në të cilat marrin pjesë klube nga Republika e Maqedonisë;

- Liga e UEFA-s në Evropë në konkurrencë të meshkujve – seniorë; Garat gjysmëfinale, gara finale dhe garat në të cilat marrin pjesë klube nga Republika e Maqedonisë;
- Gara me karakter miqësor (garat kontrolluese) në të cilët merr pjesë reprezentacioni i Maqedonisë në futboll në konkurrencë të meshkujve – senior, të cilat luhen në vend dhe jashtë kufijve të Republikës së Maqedonisë;
- Kampionati Evropian dhe botëror në basketboll në konkurrencë të meshkujve – senior; Garat gjysmëfinale, gara finale, garat në të cilat merr pjesë reprezentacioni i Maqedonisë në basketboll, përfshirë edhe garat kualifikuese në të cilat merr pjesë;
- Kampionati Evropian dhe botëror në volejball në konkurrencë të meshkujve – senior; Garat gjysmëfinale, gara finale, garat në të cilat merr pjesë reprezentacioni i Maqedonisë në volejball, përfshirë edhe garat kualifikuese në të cilat merr pjesë;
- Garat e kupave Evropiane – Liga e kampionëve në hendboll, në konkurrencë të femrave dhe meshkujve - senior: Garat gjysmëfinale, gara finale, garat në të cilat marrin pjesë ekipet nga Republika e Maqedonisë, përfshirë edhe garat kualifikuese në të cilat marrin pjesë ekipe nga Republika e Maqedonisë;
- Kampionatet evropiane dhe botërore në hendboll, në konkurrencë të grave dhe burrave – senior; Garat gjysmëfinale, gara finale, garat në të cilat merr pjesë reprezentacioni i Maqedonisë në hendboll, përfshirë edhe garat kualifikuese në të cilat merr pjesë;

3. Nëse ngjarjet me rëndësi të madhe, të theksuara në listën nga pika 2 e këtij vendimi organizohen në pjesë, atëherë çdo pjesë e veçantë e ngjarjes llogaritet si ngjarje me rëndësi të madhe.

4. Të gjitha ngjarjet me rëndësi të madhe që janë të theksuara në listën nga pika 2 e këtij Vendimi, do të emetohen drejtpërdrejtë dhe në tërësi.

Në rast kur ngjarjet me rëndësi të madhe zhvillohen njëkohësisht, ose koha e realizimit të ngjarjes është në periudhën nga ora 24:00 deri në 6:00 sipas kohës zyrtare në Republikën e Maqedonisë, atëherë radiodifuzerët e kualifikuar vetë do të vendosin se cilat ngjarje do ti emitojnë drejtpërdrejtë dhe në tërësi e cilat me prolongim, në formë të incizimit.

Emetimi i prolonguar i ngjarjes me rëndësi të madhe nuk duhet të tejkalojë 24 orë nga koha e zhvillimit të ngjarjes.

Dispozitat e kësaj pike vlejné edhe për rastet e parapara me pikën 3 të këtij Vendimi.

5. Me qëllim që të mbrohet e drejta e qasjes së publikut në ngjarjet me rëndësi të madhe, dhe të pamundësohet që ndonjë radiodifuzer, me marrjen e të drejtës ekskluzive për emetim të saj, të privojë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë nga mundësia që ta përcjell ngjarjen, potencohet se radiodifuzerët e kualifikuar për emetim të këtyre ngjarjeve janë të gjithë radiodifuzerët që i plotësojnë këto 4 (katër) kritere si vijon:

- Me sinjalin e tyre të mbulojnë së paku 80% të popullsisë në Republikën e Maqedonisë;
- Qasja deri te shërbimi i tyre programor të jetë i lirë, që do të thotë se emetohet përmes kapacitetit emetues të multipleksit digjital terestrial dhe për të nuk paguhet kompensim shtesë;
- Shërbimi programor të emetohet në formë jo të koduar; dhe
- Ngjarjet me rëndësi të madhe të emetohen në gjuhën maqedonase.

6. Nëse radiodifuzerët e kualifikuar kanë mundësi teknike, interes komercial dhe nëse sipas lejes ose sipas Ligjit (në rastin e RSP), shërbimin programor e emetojnë në më shumë gjuhë, mund

që këto ngjarje përveç në gjuhën maqedonase, ti emetojnë edhe në gjuhët e bashkësive tjera etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

7. Radiodifuzerët e kualifikuar nuk guxojnë që të përdorin të drejtat ekskluzive për emetimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe për shoqërinë në mënyrë me të cilën publiku në shtet e tjera do të pamundësohet të përcjellë ngjarjen që ai vend e ka paraqitur si ngjarje me rëndësi të madhe.

8. Për këtë Vendim, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do të njoftojë Komisionin Evropian dhe Komitetin për televizionet tejkufitare të Këshillit të Evropës dhe do të publikohet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe në ueb faqen e Agjencisë.

9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**Agjencia për shërbime mediatike audio dhe  
audiovizuale  
Kryetar i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI d.v**

NR.02-1875/1 12.03.2015 SHKUP